

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pasqyrë moj pasqyrë! Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/pasqyre-moj-pasqyre-pse-i-kemi-cmimet-kaq-te-shtrenjta-i106365
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 05:32:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 05:18:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	28a473ee022998c331e958eb169ec207aa00051f68b704d4e45a853b5f6fb1ef
TEKSTI	fdc823771d061438e68e42e2d65ad3589c807279375ca43bfd76114271d9be9b
PAMJA	a8f3a1f59061a5aae9207c8c3aa250649763e1f282c25ebe376e4cb58e14a604

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c975117d7bc3f5fd0a39f76dca28823213178b0d1f6bef5c02031f72f9e987aa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2fad39eb4a5630a03d13ec48550b069ca76ccbe736c7b94b7af60112a505f929
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c975117d7bc3f5fd0a39f76dca28823213178b0d1f6bef5c02031f72f9e987aa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

përgja...

landfille ...

e zodiakut
gjatë ditës
së sotme

gjithçka
do të
bëjnë

metra!
Bashkia

"Piranja
News",
gëndjen e

Agasit
brenda 4

brenda
AKSHI-t,
në vetëm
muaj ka

AKTUALITET

Pasqyrë moj pasqyrë! Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 07:18



Çmimet nuk ulen me urdhër, me lista publike apo me portale që krahasojnë etiketat. Ulen kur ekonomia prodhon më shumë, kur bujqësia dhe industria behen konkurruese, kur rritja e pagave mbështetet te produktiviteti, kur përmirësohet logjistika, kur taksat mbi produktet bazë rishikohen dhe kur institucionet godasin abuzimin e provuar, jo armikun e shpallur

"Padyshim që është Shqipëria, me një zgjerim prej 3.7%, duke lënë pas Kosovën (3.6%), Maqedoninë e Veriut (3.5%), Malin e Zi (2.7%), Bosnjë-Hercegovinën (2.4%) dhe Serbinë 2%", përgjigjet pasqyra, duke ndriçuar.

"Pasqyrë moj pasqyrë, cili është vendi që i ka trefishuar të ardhurat për frymë që nga viti 2013, duke ecur më shpejt se mesatarja e Ballkanit Perëndimor?". "Shqipëria, natyrisht", përgjigjet pasqyra dhe shton edhe disa ndriçues.

"Pasqyrë, mos pasqyrë, atëherë si e shpjegon ti që Shqipëria, me gjithë këto arritje, ka çmimet e ushqimeve më të larta se mesatarja e BE-së, rritje shumë të ulët të të ardhurave për frymë sipas fuqisë blerëse, emigracion të lartë dhe një nga rëniet më të forta të popullsisë në Europë në tri dekadat e fundit?"

Pasqyra, – e cila është prezantuar pikërisht si një platformë që do të rrisë transparencën dhe do t'u japë qytetarëve një pamje të drejtpërdrejtë të çmimeve në treg, – pulit ekranin, kërkon disa sekonda për përditësim dhe përgjigjet:

"Unë jam krijuar nga qeveria për t'u treguar qytetarëve ku janë çmimet më të lira, jo për të shpjeguar pse janë kaq të shtrenjta. Por, po deshët një përgjigje të shpejtë, fajin e kanë importuesit, furnitorët dhe supermarketet. Me pak fjalë, kulakët e rinj të ekonomisë së tregut. Qeveria rriti ekonominë, ata shtrenjtuan çmimet".

Meqë pasqyra nuk na dha përgjigje, po përipiqemi ta gjejmë vetë.

Rritja ekonomike e viteve të fundit është mbështetur fort në ndërtimi, konsumi, shpenzimet publike dhe taksat. Në vitin 2025, taksat neto dhe administrata publike sollën 77% të rritjes ekonomike. Rritja e pagave në administratë shtoi konsumin, të ardhurat nga tatimet e kontributet dhe presionin mbi bizneset private për të bërë të njëjtin gjë.

Por biznesi nuk i rriti pagat vetëm sepse e frymëzoi qeveria. I rriti sepse punonjësit po largoheshin.

Emigracioni krijoi mungesë të fuqisë punëtore dhe pagat u rritën pa u shoqëruar me të njëjtin përmirësim të produktivitetit. Për ndërmarrjet prodhuese kjo do të thotë kosto më të larta, konkurrueshmëri më të ulët dhe, në fund, çmime më të shtrenjta.

Këtu fillon të kriset pasqyra. Të ardhurat nominale për frymë mund të trefishohen edhe nga rritja e çmimeve, forcimi i lekut dhe zvogëlimi i numrit të banorëve mes të cilëve pjesëtohet ekonomia.

Ndërkohë, sipas fuqisë blerëse, të ardhurat mbeten rreth 48% e mesatares së BE-së, kurse çmimet e ushqimeve arritën në vitin 2025 në 102.9% të mesatares europiane. Pra, të ardhura shqiptare dhe çmime europiane.

Ndërsa ndërtimi ngrihet kat pas kati, industria përpunuese ka hyrë në cikël negativ prej të paktën nëntë tremujorësh radhazi, periudha më e gjatë e rënies apo stanjacionit pas viteve '90. Nëse prodhimi vendas dhe eksportet vazhdojnë të dobësohen, vendi rrezikon të kthehet në atë që vetë industrialistët e kanë quajtur “një supermarket i madh”: importojmë gjithçka, shesim shërbime dhe apartamente, ndërsa konsumatorët me të ardhurat më të ulëta paguajnë çmimet më të larta.

As rënia e euros nuk po kalon e plotë të konsumatori. Në shtatë muajt e parë të vitit 2026, çmimi mesatar për kilogram i importeve të ushqimeve, pijeve dhe duhanit ra me 6.5%, por çmimet e ushqimeve në treg u rritën.

Në çmimin përfundimtar përfshihen edhe transporti, magazinimi, humbjet, qiratë, trafiku sezonal, karburanti ndër më të shtrenjtët në Europë dhe TVSH-ja 20% për ushqimet, kur shumë vende europiane zbatojnë norma të reduktuara.

Mbi të gjitha, futet dobësia e prodhimit vendas dhe varësia nga importet. Mund të ketë marzhe të tepruara apo sjellje spekulative, por ato nuk vërtetohen me deklarata, duhen kontrolluar faturat, zinxhiri i furnizimit dhe niveli i konkurrencës.

Prandaj çmimet nuk ulen me urdhër, me lista publike apo me portale që krahasojnë etiketat. Ulen kur ekonomia prodhon më shumë, kur bujqësia dhe industria bëhen konkurruese, kur rritja e pagave mbështetet te produktiviteti, kur përmirësohet logjistika, kur taksat mbi produktet bazë rishikohen dhe kur institucionet godasin abuzimin e provuar, jo armikun e shpallur.

Pasqyra e Arkimedit, sipas legjendës, dogji flotën armike duke kthyer mbi të rrezet e diellit. Pasqyra e Ramës po tenton të djegë spekulimin në çmimet. Por, teksa pas saj qëndron një ekonomi që prodhon pak dhe importon shumë, rrezja rrezikon të djegë, si gjithmonë, mbi xhepin e konsumatorit./Monitor

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 28 Shtator07:13

[Rajoni dobët me menaxhimin e mbetjeve, mbi 83% përfundojnë në landfille](#)

Ballkani Perëndimor mbetet shumë larg Bashkimit Europian në menaxhimin e mbetjeve, pavarësisht investimeve të reja në landfille ...

AKTUALITET 28 Shtator07:08

[Turizmi “eco”, FSHZH lidh kontratën 2.4 milionë euro për glamping, tree houses e park aventure në Belsh](#)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) njoftoi së fundmi se ka lidhur kontratën për zgjerimin e Eco Park Dumrea në Belsh, projekti që...

AKTUALITET 27 Shtator21:10

[Shifrat e “çmendura” prej miliona euro të fitimeve të kompanisë së Ergys Agasit brenda 4 muajve të parë](#)

Kompania e Ergys Agasit i arrestuar me urdhër të SPAK për grup të strukturuar kriminal brenda AKSHI-t, në vetëm muaj ka arritur ...

AKTUALITET 27 Shtator20:57

[Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare](#)

Nëse historia e tranzicionit të Shqipërisë do të kishte qenë ndryshe, edhe fati i qindra mijëra të rinjve që emigru...

AKTUALITET 27 Shtator20:47

[EMRI/ Jetonte i vetëm dhe i paralizuar, identifikohet viktimi e zjarrit në Fier](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në fshatin Fermë Çlirim, ku një 70-vjeçar ka ...

AKTUALITET 27 Shtator20:29

[EMRI/ Arrestohet 56-vjeçari shqiptar në Boston, akuzohet për tentativë abuzimi seksual ndaj të mitur* t](#)

Autoritetet amerikane kanë arrestuar një shtetas shqiptar 56-vjeçar në kuadër të një operacioni të posaçëm...

AKTUALITET 27 Shtator20:06

[VIDEO- E rëndë në Fier/ Burri i paralizuar humb jetën nga zjarri në shtëpi](#)

Një 70-vjeçar ka humbur jetën si pasojë e një zjarri që përfshiu banesën ku jetonte në Fermë-Çlirim. ...

AKTUALITET 27 Shtator20:04

[Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga fitimet minimale në 2019-ën, te bizneset në vlerën e 1 milionë eurove në ‘26-ën!](#)

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

AKTUALITET 27 Shtator19:20

[Zjarr në Ndërrenas/ Dëgjen parcelat me ullinj, flakët rrezikojnë sera dhe stalla](#)

Një zjarr që ka nisur në anë të kanaleve vaditës në fshatin Ndërrenas të Libofshës ka marrë përmasa ...

AKTUALITET 27 Shtator 18:36

[EMRI/ Aksident tragjik në Cërrik, humb jetën 21-vjeçari, plagoset adoleshenti. Si ndodhi ngjarja](#)

Një aksident i rëndë ka ndodhur në lagjen nr. 3 të Cërrikut, ku një 21-vjeçar i identifikuar si Marculino Osmani, ka h...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare t&...

INVESTIGIME 26 Shtator 13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.